

RAPORTI VJETOR

2024

IEKA



INSTITUTI I EKSPERTËVE
KONTABËLTË AUTORIZUAR
TË SHQIPËRISË

**SHTATOR
2025**

Përgatitur nga:

**STRUKTURA
EKZEKUTIVE**

Përgatitur për:

**ASEMBLEJA E
PËRGJITHSHME**

KY RAPORT DHE TË DHËNAT NË PËRMBAJTJE TË TIJ JANË E DREJTË AUTORI. TË GJITHË TË DREJTAT JANË TË REZERVUARA PËR INSTITUTIN E EKSPERTËVE KONTABËLTË AUTORIZUAR NË SHQIPËRI.

KOPJIMI DHE PËRHAPJA E TË DHËNAVE APO PËRDORIMI TREGTAR I KËTIJ RAPORTI NUK ËSHTË I LEJUAR PËRVEÇ KUR JEPET MIRATIM ME SHKRIM. ËSHTË I NDALUAR VENDOSJA E KËTIJ RAPORTI NË FAQE INTERNETI EDHE KUR KJO BËHET PA PAGESË, NËSE NUK ËSHTË MARRË APROVIMI PARAPRAK NGA IEKA.

PËRDORIME TË TJERA QË NUK PARASHIKOHEN NË KËTË SEKSION JANË TË LEJUARA VETËM NËSE BURIMI I INFORMACIONIT CITOHEË ME SAKTËSI “INSTITUTIN E EKSPERTËVE KONTABËLTË AUTORIZUAR”.

TIRANË, 2025

PËRMBAJTJA

MESAZHI
KRYETARIT 1

MESAZHI I DREJTORIT
EKZEKUTIV 2

MISIONI E
OBJEKTIVAT 3

ORGANIZIMI DHE
QEVERISJA 4

AKTIVITETET
KRYESORE 2024 5

BASHKËPUNIME
DHE PARTNERITETE 6

VEPRIMTARIA
FINANCIARE 7

PASQYRAT
FINANCIARE 8

SFIDAT DHE
PRIORITETET 9

INFORMACION
KONTAKTI 10

PËRMBEDHJE EKZEKUTIVE



Raporti Vjetor 2024 i IEKA paraqet një panoramë të plotë të veprimtarisë së institutit gjatë vitit, duke nisur me mesazhet udhëheqëse të Kryetarit dhe Drejtorit Ekzekutiv dhe vijuar me misionin, objektivat strategjike dhe strukturën e qeverisjes. Dokumenti pasqyron aktivitetet kryesore të vitit, performancën financiare dhe pasqyrat përkatëse, si dhe bashkëpunimet me partnerë vendas e ndërkombëtarë. Në fund, theksohen sfidat dhe prioritetet që do të udhëheqin zhvillimin e institutit në vitet e ardhshme, së bashku me informacionin e plotë të kontaktit për anëtarët dhe palët e interesuara.

KRYESORET



AKTIVITETET
2024



VEPRIMARIA
FINANCIARE



ORGANIZIMI



MESAZH I KRYETARIT



BERTI PASHKO

KRYETARI I IEKA

Të nderuar anëtarë të Asamblesë,

Katër vitet e fundit kanë qenë ndër më sfidueset në historinë e Institutit tonë. Kam zgjedhur të jem i hapur, sepse e vërteta i shërben më shumë të ardhmes sonë se çdo raport me fjalë të bukura. Ne kemi kaluar periudha me çështje ligjore të ndërlikuara, me mungesë të vullnetit për bashkëpunim brenda Këshillit Drejtues dhe me tensione që shpesh na kanë penguar të ecim me ritmin që anëtarët meritojnë. Ka pasur momente kur vendimmarrja është bllokuar jo nga mungesa e ideve, por nga mungesa e frymës së përbashkët.

Këto vështirësi nuk e kanë zbehur detyrimin tim për të ruajtur integritetin e Institutit dhe për ta mbajtur atë funksional, por më kanë mësuar diçka thelbësore: asnjë nismë, sado e mirë, nuk mbijeton pa besim dhe bashkëpunim.

Pas një muaji, ju do të zgjidhni Këshillin e ri Drejtues. Ky është momenti për të reflektuar thellë. Ju ftoj të zgjidhni individë që sjellin energji pozitive, që dinë të dëgjojnë, që e vendosin interesin e profesionit mbi çdo interes personal. IEKA nuk ka nevojë për njerëz që ruajnë pozitat, por për profesionistë që duan të ndërtojnë, të bashkëpunojnë dhe të udhëheqin me integritet.

Ky është thirrja ime e sinqertë: le të mbyllim një kapitull të vështirë dhe të hapim një tjetër, ku fjala “bashkë” nuk mbetet vetëm në statut, por kthehet në mënyrë veprimi. E ardhmja e Institutit nuk do të matet me emra, por me kulturën e besimit që do të ndërtojmë së bashku.

Me respekt,
Berti Pashko

MESAZHI DREJTORIT EKZEKUTIV

Të nderuar anëtarë,

Viti 2024 ka qenë një vit pune të ngjeshur për strukturën ekzekutive të Institutit. Qëllimi ynë ka qenë i qartë: të mbështesim Këshillin Drejtues dhe të sigurojmë funksionimin e përditshëm të IEKA-s me korrektësi dhe transparencë.

Në nivel organizativ, stafi ynë ka menaxhuar me kujdes proceset e edukimit të vijueshëm profesional, regjistrimet e reja të audituesve ligjorë dhe administrimin e shërbimeve për anëtarët. Janë zhvilluar dhe përfunduar të gjitha sesionet e planifikuara të kualifikimit profesional, janë përditësuar regjistrat publikë dhe janë përmbushur të gjitha kërkesat ligjore për raportim e kontroll të cilësisë.

Në fushën financiare, kemi arritur të ruajmë ritmin e të ardhurave, duke tejkaluar buxhetin e miratuar, por kemi hasur edhe sfida që kërkojnë vëmendje: arkëtimet e kuotave të prapambetura, rritja e shpenzimeve të paparashikuara dhe efekti i tarifës së Bordit të Mbikëqyrjes Publike.

Kemi bërë hapa konkretë në optimizimin e likuiditetit dhe në forcimin e kontrolleve të brendshme, duke përmirësuar proceset e raportimit dhe monitorimit financiar.

Ky raport pasqyron punën e një ekipi të përkushtuar që, pavarësisht vështirësive, ka garantuar vijueshmërinë e veprimtarive dhe stabilitetin e institucionit. Përpara nesh janë sfida të reja: forcimi i disiplinës financiare, modernizimi i proceseve dhe rritja e efikasitetit në shërbim të anëtarëve.

Me respekt,

Doranin Agalliu

Drejtor Ekzekutiv, IEKA



DORANIN AGALLIU
DREJTOR EKZEKUTIV I IEKA



MISIONI DHE OBJEKTIVAT

VIZIONI

IEKA aspirojnë të jetë institucioni lider jo vetëm në Shqipëri por edhe në rajonin e Europës Juglindore për zhvillimin e profesionit të auditimit dhe raportimit financiar. Ne synojmë të krijojmë një komunitet profesional modern, të besueshëm dhe të vlerësuar, që kontribuon në transparencën e tregjeve financiare, stabilitetin ekonomik dhe afrimin e Shqipërisë me praktikatat më të mira ndërkombëtare. Vizioni ynë është të ndërtojmë një profesion të respektuar, ku cilësia e auditimit është garanci për investitorët, bizneset dhe qytetarët.

MISIONI


Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar ka mision të garantojë cilësinë, integritetin dhe pavarësinë e profesionit të auditimit ligjor në Shqipëri, duke mbrojtur interesin publik dhe duke ndërtuar besim tek raportimi financiar. Përmes vendosjes së standardeve më të larta etike dhe profesionale, IEKA angazhohet të forcojë përgjegjshmërinë, transparencën dhe qëndrueshmërinë e subjekteve ekonomike dhe institucioneve publike që auditohet.



OBJEKTIVAT

- **Forcimi i sistemit të kontrollit të cilësisë** – duke zbatuar rregullore të reja, praktika inspektimi më rigoroze dhe duke garantuar përputhshmërinë me standardet ndërkombëtare të ISQM dhe ISA.
- **Zhvillimi i edukimit profesional** – rritja e cilësisë së programeve të edukimit fillestar dhe të kualifikimit të vijueshëm profesional (EVP/CPD), integrimi i moduleve bashkëkohore mbi teknologjinë, financat digjitale dhe standardet ndërkombëtare të raportimit financiar (IFRS).
- **Përafrimi me *acquis communautaire* të BE-së** – implementimi i direktivave të Bashkimit European në fushën e auditimit dhe sigurimi i një procesi të vazhdueshëm harmonizimi me praktikat më të mira të vendeve anëtare.
- **Promovimi i profesionit të gjeneratat e reja** – përmes bashkëpunimit me universitetet, programeve të bursave, praktikave profesionale dhe fushatave të ndërgjegjësimit mbi rëndësinë e auditimit.
- **Transformimi digjital i IEKA-s** – ndërtimi i platformave online për edukim, raportim dhe komunikim me anëtarët; dixhitalizimi i arkivave dhe proceseve administrative; adoptimi i inteligjencës artificiale në mbështetje të inspektimeve dhe analizës së të dhënave.
- **Zhvillimi i kapaciteteve për auditimet e qëndrueshmërisë (ESG)** – integrimi i kriterëve mjedisore, sociale dhe të qeverisjes në auditim dhe edukimi i anëtarëve për të përmbushur kërkesat e reja globale mbi raportimin e qëndrueshëm.
- **Forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar** – rritja e rolit të IEKA në organizatat profesionale globale dhe rajonale si IFAC, EFAA dhe FCM, duke përfaqësuar me dinjitet profesionin shqiptar në arenën ndërkombëtare.

ORGANIZIMI DHE QEVERISJA



ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

Përbëhet nga 250 anëtarë aktivë.
Është organi më i lartë vendimmarrës.

KOMITETI I KONTROLLIT TË BRENDSHËM

kryetar+ 2 anëtarë
Mbikëqyr veprimtarinë dhe zbatimin e rregullave.

KËSHILLI DREJTUES

Kryetar + 6 anëtarë
Drejton strategjinë dhe vendimet kryesore.

KOMITETI I REGJISTRIMIT

Kryetar IEKA + 5 anëtarë
Merret me proceset e regjistrimit të anëtarëve.

KOMITETI I EDUKIMIT DHE KUALIFIKIMIT TË VIJUESHËM PROFESIONAL (KKEV)

Kryetar+ 4 anëtarë

KOMITETI I INVESTIGIMIT & DISIPLINËS (KID)

Kryetar+ 3 anëtarë
Trajton çështjet disiplinore dhe hetimet e brendshme.

KOMITETI I SIGURISË PËR CILËSINË (KC)

kryetar+ 4 anëtarë
Përgjegjës për kontrollin dhe sigurimin e cilësisë.

KOMITETI I STANDARDEVE PROFESIONALE

3 anëtarë
Zhvillon dhe azhurnon standardet profesionale.

KËSHILLI I BOTIMIT TË REVISTËS KONTABILITET & AUDITIM

5 anëtarë
Përkujdeset për botimet dhe revistën zyrtare.

STRUKTURA EKZEKUTIVE

Drejtori Ekzekutiv & Stafi Ekzekutiv
Mbështet punën operacionale dhe
zbaton vendimet e Këshillit Drejtues.

ORGANET DREJTUESE

KËSHILLI DREJTUES ËSHTË ORGANI DREJTUES I INSTITUTIT. AI PËRBËHET NGA KRYETARI DHE GJASHTË ANËTARË, TË ZGJEDHUR NGA ASAMBLEJA PËR NJË MANDAT 4-VJEÇAR. KY KËSHILL ËSHTË ZGJEDHUR PJESËRISHT NË MBLEDHJEN E DATËS 15 TETOR 2021 DHE PJESËRISHT MË 14 QERSHOR 2022, DUKE GARANTUAR NJË PËRFAQËSIM TË BALANCUAR DHE VAZHDIMËSI NË VENDIMMARRJE.



Berti Pashko

KRYETAR



Shpresa Breçani

ZV/KRYETAR



Esmeralda Balluku

ANËTAR



Edrian Meslani

ANËTAR



Ilda Duhanxhiu

ANËTAR



Desara Lika

ANËTAR



Kamela Hasko

ANËTAR

VEPRIMTARIA E KËSHILLIT TË DREJTIMIT NË 2024

Gjatë vitit 2024 Këshilli Drejtues ka realizuar 11 mbledhje dhe ka marrë 58 vendime të cilat lidhen kryesisht me:

-  Miratimin e propozimeve, vendimeve apo rregulloreve të komiteteve të IEKA-s si dhe raporteve vjetore të tyre.
-  Miratimin e listëprezencës për pjesëmarrje në testimin për konvertimin e orëve të munguara të KVP-së.
-  Miratimin e projekt-buxhetit 2025, rialokimin e fondeve të buxhetit 2024 dhe shpërblimin e fund-vitit për stafin ekzekutiv të IEKA-s.
-  Miratimin për kandidatët e viteve të ndryshme, të testeve hyrëse, moduleve dhe programin e punës, praktikën e tyre, kalimin në vitin pasardhës si dhe miratimi i përfundimit të praktikës profesionale për kandidatët e vitit të III-të.
-  Miratimin e projekt-buxhetit të KPAP-së dhe konfirmimin e Sekretariatit Teknik.
-  Miratimin e lektoreve për praktikën profesionale.
-  Miratimet ose mosmiratimet për përjashtim nga praktika profesionale të kandidatëve të cilët plotësojnë ose jo kriteret ligjore ose janë anëtar të ACCA-së.
-  Miratimin e programit të kualifikimit të vijueshëm të anëtarëve për vitin 2024.
-  Miratimin ose jo të orëve të certifikuar të edukimit të vijueshëm profesional (CPD) të organizuara nga organizata të tjera përveç IEKA-s, për anëtarët aktiv të IEKA-s.
-  Miratimin e rregullores të KKC-së me ndryshimet e propozuara nga BMP-ja.
-  Përditësimin e listës së organizatave të cilat ofrojnë trajnime të certifikuar të konvertueshme në orë të kualifikimit të vijueshëm profesional. Në listë është shtuar dhe Banka Botërore(BB).
-  Vendimin nr. 27, datë 15.04.2024, lidhur me përcaktimin e orëve minimale të punës për auditimet ligjore, duke shfuqizuar vendimin nr. 51, datë 22.12.2023, me përmbajtje të ngjashme.



EDUKIMI DHE KUALIFIKIMI I VIJUESHEM

Komiteti i Edukimit dhe Kualifikimit të Vijueshëm Profesional është përgjegjës për hartimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të politikave që lidhen me edukimin e kandidatëve dhe zhvillimin e vijueshëm profesional të anëtarëve. Komiteti i propozon Këshillit Drejtues programet përkatëse, si dhe merret me monitorimin dhe vlerësimin e ecures së tyre.

Në 31 dhjetor 2024 Komiteti i Edukimit dhe Kualifikimit të Vijueshëm Profesional, ka përbërjen e mëposhtme:

Edrian Meslani (Kryetar)

Jonid Lamllari (Anëtar)

Armand Hasko (Anëtar)

Ingegerta Bebi (Anëtar)

Eglina Pjetërnikaj (Anëtar)

Gjatë vitit 2024, KEKV-ja ka zhvilluar 12 mbledhje dhe ka miratuar gjithsej 49 vendime, të cilat përmbledhin ndër të tjera:

- Miratimi i moduleve të reja për programin postmaster;
- Vendosja e tarifës 8.000 lekë për aplikimet për përjashtim nga praktika profesionale;
- Njohja e orëve të certifikuara nga ACCA dhe SCAAK (ShKÇAK);
- Finalizimi i trajnimeve dhe testimeve për programin postmaster dhe modulet kryesore të kualifikimit;
- Shqyrtimi i kërkesave për përjashtim nga praktika profesionale.
- Koordinimi i kandidatëve të regjistruar në programin postmaster për AL;
- Përmbyllja e sesionit të parë dhe sesionit të dytë të kualifikimit të vijueshëm profesional për vitin 2024.



KONTROLLI I CILËSISË

Komitetiti i Kontrollit të Cilësisë ka për qëllim të sigurojë verifikimin dhe dhënien e sigurisë për cilësinë e auditimit, duke u kujdesur që audituesit ligjorë dhe ortakët e angazhimit të veprojnë në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregulloret në fuqi dhe, në të njëjtën kohë, shoqëritë e auditimit të përmbushin me integritet dhe profesionalizëm detyrimet e tyre, duke iu përgjigjur në mënyrë efektive kërkesave të ushtrimit të profesionit.

Më 31 dhjetor 2024 KKC-ja ka përbërjen si më poshtë:

Esmeralda Balluku (Kryetare)
Arjan Çyrbja (Anëtar)
Gentian Tata (Anëtar)
Elida Miti (Anëtar)
Ermir Veipi (Anëtar)

Me vendim të BMP-së, realizimi i procesit të kontrollit për sigurimin e cilësisë të njërive ekonomike me interes jopublik është deleguar pranë organizatës profesionale të audituesve ligjorë -IEKA.

Në këtë kuadër, IEKA ka marrë masat:

- Duke reformuar Komitetin e Kontrollit të Cilësisë;
- Duke hartuar një paketë të plotë të rregullave të kontrollit të cilësisë bazuar në eksperiencën dhe ndihmën e konsulentit të projektit të Bankës Botërore;
- Duke angazhuar me kohë të plotë dy inspektorë të kontrollit të cilësisë nga viti 2023, të cilët plotësojnë kriteret ligjore.
- KKC-ja ka hartuar draft rregulloren e kontrollit të cilësisë, për të cilën BMP-ja ka bërë komentet dhe sugjerimet për përmirësim lidhur me bazën ligjore, përmbajtjen e rregullores dhe kuadrin e delegimit



REGJISTRI PUBLIK

Komiteti i Regjistrimit i cili ka objektiv kryesorë zbatimin e procedurave të regjistrimit dhe çregjistrimit të AL-ve dhe shoqërive të auditimit ka pasur këtë përbërje gjatë vitit 2024:

Ilda Duhanxhiu (Kryetare)
Saimir Muçmataj (Nënkryetar)
Ervin Sherifaj (Anëtar)
Arbër Kalluçi (Anëtar)
Ilir Meçe (Anëtar)

Gjatë vitit 2024, Komitetit ka kryer 7 mbledhje në të cilat janë marrë 98 vendime. Sipas nenit 19 të ligjit 10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar“, Komiteti i Regjistrimit mbledhet një herë në dy muaj, në javën e parë të muajit pasardhës.

Në kuadrin e punës së kryer gjatë vitit, Komiteti ka paraqitur një raport të detajuar në lidhje me të gjitha ndryshimet në regjistrin e audituesve ligjorë, përfshirë këtu:

- Regjistrimet e reja të audituesve ligjorë si persona fizikë ose në shoqëri auditimi;
- Regjistrimet e reja të shoqërive të auditimit;
- Regjistrimet e audituesve ligjorë që nuk e ushtrojnë profesionin;
- Ri-regjistrimet e audituesve ligjorë si persona fizikë ose në shoqëri auditimi;
- Pezullimet e përkohshme të audituesve ligjorë;
- Çregjistrimet nga regjistri publik i IEKA-s.

STRUKTURA EKZEKUTIVE



DREJTORI EKZEKUTIV

Z.Doranin Agalliu

EMEROHET NGJA

KËSHILLI DREJTUES

MANDAT

4-VJECAR

Organi ekzekutiv i IEKA-s është Drejtori Ekzekutiv, i cili ka përgjegjësinë për organizimin e punës, zbatimin e vendimeve të Këshillit Drejtues dhe administrimin e buxhetit sipas rregullave financiare të miratuara.

Aktualisht, këtë funksion e ushtron z. Doranin Agalliu, i cili fillimisht mbajti këtë rol në mënyrë të komanduar (janar–nëntor 2023) dhe më pas u emërua zyrtarisht për një mandat 4-vjeçar më 30 nëntor 2023.



STAFI EKZEKUTIV

EMEROHET NGJA

**DREJTORI EKZEKUTIV,
ME MIRATIM TE KRYETARIT**

POZICIONE

8

Struktura organizative e personelit ekzekutiv të Institutit përbëhet nga sektorët e mëposhtëm:

- Sektori i edukimit profesional të kandidatëve dhe kualifikimit të vijueshëm të anëtarëve
- Sektori i standardeve dhe i publikimeve profesionale
- Sektori i Kontrollit të Cilësisë
- Sektori i financës e kontabilitetit;
- Sektori i shërbimeve mbështetëse dhe logjistikës

STAFI EKZEKUTIV



Me mbështetjen e Bankës Botërore, inspektorët e IEKA kanë marrë pjesë në trajnimet kualifikuese të ICAEW, duke u certifikuar për kontrollet e cilësisë së auditimit. Në vitin 2025, pritet të financohet zgjerimi i numrit të inspektorëve dhe ngritja e një programi të ri përkontrollin e cilësisë.

KONTROLLI I CILËSISË

Z.Xhoxhi Lera
Z.Orjal Shaholli

POZICIONE

2

Gjatë vitit 2024, IEKA ka rritur përpjekjet për të siguruar një edukim të vijueshëm cilësor për anëtarët e saj, duke u fokusuar në katër shtylla kryesore:



- Standardet e Auditimit dhe Menaxhimi i Cilësisë – Përfshirja e rregullave mbi kontrollin e brendshëm, etiken profesionale dhe teknikat e rishikimit profesional.
- Legjislacioni Kontabël– Implementimi i SKK, SNK, IFRS dhe metodologjitë e analizës financiare.
- Legjislacioni Juridik– Ligji për falimentimin, taksat vendore dhe aspektet civile, tregtare dhe penale.
- Teknologjia dhe Transformimi Digjital – Përdorimi i platformave digjitale për qasje më të lehtë në burime arsimore dhe mjete profesionale.

SEKTORI I EDUKIMIT DHE KUALIFIKIMIT

Znj.Antonela Mersini

POZICIONE

1

STRUKTURA EKZEKUTIVE



Në vitin 2024, standardet ndërkombëtare të auditimit u përditësuan për të përballuar sfidat e reja të tregut financiar global, përfshirë rritjen e kërkesave për transparencë, etikë dhe qëndrueshmëri.

- Përditësimi i Kodit Ndërkombëtar të Etikës (IESBA)
- Përmirësimi i Standardeve të Auditimit Ndërkombëtar (IAASB) (570, 600, LCE)
- Standarde të Reja për Sigurimin e Qëndrueshmërisë (ISSA 5000)
- Struktura e Kodit të IAASB për Vitin 2023-2024

SEKTORI I STANDARTEVE PROFESIONALE

Znj. Edes Dhaless

POZICIONE

1



Sektori i Financës siguron menaxhimin dhe kontrollin e plotë të burimeve monetare të Institutit, duke përfshirë përgatitjen dhe zbatimin e buxhetit vjetor, raportimin financiar periodik, administrimin e kuotave të anëtarëve dhe mbikëqyrjen e të gjitha detyrimeve ligjore e fiskale. Ky sektor harton pasqyrat financiare, monitoron përdorimin e fondeve sipas vendimeve të organeve drejtuese dhe garanton transparencë e saktësi në çdo proces financiar të IEKA-s.

SEKTORI I FINANCËS DHE KONTABILITETIT

Znj. Silda Metani

POZICIONE

1

STRUKTURA EKZEKUTIVE



- **Regjistrime për herë të parë:** 10 auditues ligjorë, 5 shoqëri auditimi dhe 8 auditues ligjorë që nuk ushtrojnë profesion.
- **Ri-regjistrime:** 7 auditues ligjorë dhe 19 shoqëri auditimi.
- **Pezullime të përkohshme** të ushtrimit të profesionit: 5 auditues ligjorë.
- **Çregjistrime:** 3 auditues ligjorë, 3 shoqëri auditimi dhe 15 auditues ligjorë të dalë në pension.

REGJISTRI DHE SEKRETARIA

Znj.Silvi Buzi

POZICIONE

1



Sektori i Mirëmbajtjes dhe Logjistikës kujdeset për infrastrukturën dhe funksionimin e përditshëm të zyrave të Institutit, duke siguruar ambient pune të sigurt e efikas. Ky sektor menaxhon mirëmbajtjen teknike, furnizimet, shërbimet logjistike për aktivitetet dhe mbështetjen operative për të gjitha departamentet, në mënyrë që veprimtaria e IEKA-s të zhvillohet pa ndërprerje.

LOGJISTIKË DHE MIRËMBAJTJE

Znj.Albana Pllaha
Z.Fitim Haliaj

POZICIONE

2

PËRMIRËSIMI I LIGJIT TË PROFESIONIT



Në përputhje me kërkesat e standardeve ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë ISQM 1 & 2, gjatë vitit 2024 IEKA luajti një rol thelbësor në procesin e ndryshimeve ligjore për auditimin ligjor. Këto hapa e shënojnë përkushtimin e institutit për forcimin e qeverisjes dhe garantimin e cilësisë në profesion.

- **KONSULTIMI PUBLIK – MAJ 2024**

IEKA paraqiti sugjerime dhe vërejtje të detajuara në një konsultim publik mbi ndryshimet në ligjin Nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor”, duke theksuar nevojën për rritjen e transparencës dhe forcimin e kontrollit të cilësisë.

- **BASHKËPUNIMI INSTITUCIONAL**

Pas konsultimeve të vazhdueshme me Ministrinë e Financave dhe Bordin e Mbikëqyrjes Publike, u arrit dakordësia për ndryshimet thelbësore, duke përfshirë rritjen e rolit të Mbikëqyrjes Publike në mbrojtje të interesit publik.

- **MIRATIMI I LIGJIT TË RI – DHJETOR 2024**

Kuvendi miratoi më 19.12.2024 ligjin e përditësuar me nr. 126/2024, i cili forcon ndjeshëm mekanizmat e kontrollit të cilësisë dhe përafron rregullat vendase me standardet ndërkombëtare.

Ky proces shënon një hap strategjik drejt rritjes së besueshmërisë së profesionit të auditimit në Shqipëri dhe tregon qartë rolin udhëheqës të IEKA në zhvillimin dhe mbrojtjen e interesit publik në fushën e auditimit ligjor.

BASHKËPUNIME DHE PARTNERITETE



FORUMI I DREJTORËVE GLOBAL TË EDUKIMIT

Në këtë forum u diskutua ndikimi i ndryshimeve globale në profesionin e kontabilitetit dhe auditimit, duke trajtuar çështje kyçe, si:

- Roli i kontabilistëve dhe auditorëve në luftën kundër korrupsionit.
- Integrimi i inteligjencës artificiale në profesion.
- Rëndësia e certifikimeve dhe kualifikimeve profesionale, për të garantuar një reputacion dhe ndikim global të profesionit.



KONFERENCA NDËRKOMBËTARE E EFAA

Konferenca, e zhvilluar në Bruksel, Belgjikë, kishte si temë kryesore:

“Përgatitja e profesionistëve të praktikave të vogla dhe të mesmepër vitet në vijim”, duke trajtuar disa nga çështjet më kyçe për të ardhmen e profesionit

- Ndikimi i inteligjencës artificiale në profesionin e kontabilitetit dhe auditimit.
- Raportimi i qëndrueshmërisë dhe kërkesat e reja rregullatore.
- Atraktiviteti i profesionit dhe mënyrat për të nxitur angazhimin e të rinjve.
- Shkëmbimi i përvojave mes ekspertëve ndërkombëtarë.
- E ardhmja e profesionit në një mjedis në transformim të shpejtë.

BASHKËPUNIME DHE PARTNERITETE

KONFERENCA VJETORE E FEDERATËS MESDHETARE TË KONTABILISTËVE (FCM)



Konferenca Vjetore u fokusua në çështje kyçe për zhvillimin e profesionit të kontabilitetit dhe auditimit, duke trajtuar temat:

- Korniza mesdhetare për ESG (Environmental, Social, and Governance).
- Ndikimi i ESG në rajon dhe sfidatë integritetit.
- Raporti i integruar dhe roli i tij në qëndrueshmëri.
- Auditimi më pak kompleks, si një qasje për thjeshtimin e proceseve dhe rritjen e efikasitetit.

MBLEDHJA E PËRGJITHSHME E ASAMBLESË SË FCM



Assembleia geral e celebração dos 25 anos da FCM -
Fédération des Experts Comptables... see more

Kryetari i IEKA, Z. Berti Pashko, përfaqësoi organizatën në Mbledhjen e Përgjithshme të Asamblesë së Federatës Mesdhetare të Kontabilistëve (FCM), e cila u mbajt në Paris, Francë.

Në kuadër të takimit, u organizua edhe ceremonia festive me rastin e 25-vjetorit të themelimit të FCM-së, ku morën pjesë anëtarët e FCM-së, si dhe përfaqësues nga organizata të tjera të kontabilitetit dhe auditimit.

Ky jubile shënoi një moment të rëndësishëm për bashkëpunimin mes profesionistëve të kontabilitetit dhe auditimit, duke theksuar kontributin e FCM-së në zhvillimin e standardeve profesionale dhe forcimin e rrjetit mesdhetar të kontabilistëve

BASHKËPUNIME DHE PARTNERITETE



MBLEDHJA E PËRGJITHSHME E ASAMBLESË DHE TAKIMI I EKSPERTËVE TË EFAA

Kryetari i Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA), Z. Berti Pashko, mori pjesë online në Mbledhjen e Përgjithshme të Asamblesë dhe takimin e grupit të ekspertëve të Federatës Evropiane të Kontabilistëve dhe Auditorëve për NVM (EFAA).

Kjo pjesëmarrje nënvizon angazhimin e IEKA për të kontribuar në zhvillimin e profesionit të kontabilitetit dhe auditimit, duke u përfshirë në diskutime strategjike, shkëmbimin e praktikave më të mira dhe forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar.



PROGRAMI “REPARIS FOR SMES”

Anëtarët e IEKA morën pjesë në punëtorinë e QRRF-së me temë "Menaxhimi Financiar – Trajnimi i Trajnerëve", e organizuar në kuadër të programit “REPARIS for SMEs”.

Ky program synon të forcojë kapacitetet profesionale dhe të sigurojë që profesionistët të jenë të përgatitur për sfidat e reja në menaxhimin financiar dhe raportimin e bizneseve të vogla dhe të mesme.

VEPRIMTARIA FINANCIARE

Viti 2024 shënoi një aktivitet financiar dinamik, me të ardhura në rritje, por me një rezultat përfundimtar negativ, i ndikuar kryesisht nga rritja e detyrimeve ndaj Bordit të Mbikëqyrjes Publike (BMP) dhe kostot në rritje të personelit.

Buxheti dhe vendimmarrja

Buxheti fillestar u miratua nga Këshilli Drejtues me vendimin nr. 36, datë 14.09.2023 dhe u aprovua nga Asambleja e Përgjithshme më 7 dhjetor 2023. Buxheti i rishikuar u miratua në dhjetor 2024, pas analizës së realizimeve dhe nevojave financiare.

Të ardhurat

Kuotat vjetore për anëtarët janë përcaktuar si më poshtë:

- 60 000 lekë për çdo anëtar aktiv (vendimi nr. 146, 17.12.2020 i APA-s).
- 8 000 lekë për çdo anëtar jo-aktiv (vendimi nr. 20, 28.05.2014, miratuar nga APA më 28.06.2014).
- Kuota variabël: 0,5 % e qarkullimit total deri 8 mln lekë dhe 0,3 % mbi 8 mln lekë.



Burimet kryesore të të ardhurave përfshijnë kuotat fikse e variabël, regjistrimet/çregjistrimet e audituesve ligjorë, si dhe të ardhurat nga trajnime dhe botime. Realizimi i të ardhurave arriti 108,3 % të buxhetit, ose 2 671 mijë lekë mbi parashikimin, ku veçanërisht kuota variabël nga misionet e realizuara prej AL-ve u tejkalua me 119 % (1 948 mijë lekë mbi buxhet).



Burime

34.9M



Përdorime

37.7M



Teprica

-2.8M



Përdorimet u orientuan në:

- Pagat dhe kontributet e personelit.
- Honoraret e Këshillit Drejtues dhe komiteteve.
- Kuotat e anëtarësimit në organizata ndërkombëtare.
- Shërbime të marra nga palë të treta për veprimtarinë e institutit.
- Organizimin e trajnimeve të vijueshme dhe aktiviteteve për anëtarët.

Përdorimet tejkaluan buxhetin me 2,28 % ose 797 mijë lekë. Një zë i rëndësishëm ishte tarifa ndaj BMP, e cila për vitin 2024 arriti 5 493 mijë lekë (përfshirë edhe diferencën e 7 % të vitit 2023), pas rritjes së përqindjes nga 7 % në 14 % sipas vendimit të BMP-së.

Rezultati financiar

- Teprica operative (pa tarifën BMP): +2 603 mijë lekë.
- Pas përfshirjes së tarifës BMP: -2 890 mijë lekë, rreth 214,6 % më e lartë se deficitin e parashikuar, duke sjellë një diferencë negative prej 1 543 mijë lekësh krahasuar me buxhetin e rishikuar.

* Pavarësisht rritjes së qëndrueshme të Burimeve disa faktorë kanë ndikuar në rezultat:

- Rritja e kostove të personelit dhe kontributeve shoqërore/shëndetësore, në linjë me tendencat kombëtare.
- Dyfishimi i tarifës së BMP-së nga 7 % në 14 %, me efekt të drejtpërdrejtë në pasqyrat financiare.

* Teprica operative (pa tarifën BMP): +2,603 mijë lekë.

Pas përfshirjes së tarifës BMP: -2 890 mijë lekë, rreth 214,6 % më e lartë se deficitin e parashikuar, duke sjellë një diferencë negative prej 1 543 mijë lekësh krahasuar me buxhetin e rishikuar.

3%

Rritja e Burimeve



15%

Rritja e Përdorimeve



PASQYRAT FINANCIARE

* PASQYRA E BURIMEVE TË FONDEVE

Të ardhurat totale për vitin 2024 janë 34,475,270 lekë, me një rritje prej 2.67% nga viti 2023. Rritja vjen kryesisht nga kuotat e anëtarësimit. Shpenzimet janë rritur:
·Pagat dhe sigurimet janë rritur me 5.16 milion lekë.
·Shpenzimet administrative janë rritur me rreth 1.89 milion lekë.

Burimet	34.5M
Përdorimet	37.7M
Teprica	-2.8M

* POZICIONI FINANCIAR

Totali i aktiveve më 31 dhjetor 2024 është 137,155,520 lekë, që përfaqëson një rënie prej 1.42% krahasuar me vitin 2023 (139,130,639 lekë). Kjo rënie vjen kryesisht nga:
·Zbritja e aktiveve afatgjatamateriale prej 1,282,144 lekë.
·Rënie e mjeteve monetare me rreth 1.36 milion lekë.

Aktive	137.2M
Detyrime	7.3M
Kapitali neto	128.9M

* FLUKSET E MJETEVE MONETARE

·Fluksi neto i parasë nga aktiviteti i shfrytëzimit është negativ: -1,198,569 lekë.
·Fluksi neto total për vitin është -1,363,782 lekë.
·Mjetet monetare në fund të vitit janë 82,724,516 lekë, krahasuar me 84,088,297 lekë një vit më parë.

Operative	-1.2M
Investime	

PRIORITET E SFIDAT

IEKA po planifikon një zhvillim të qëndrueshëm dhe modernizim të plotë të profesionit të auditimit, duke ndjekur standardet më të larta ndërkombëtare dhe duke përqafuar teknologjinë e avancuar. Objektivat kryesorë fokusohen në:

PRIORITETET STRATEGJIKE

- **Qeverisje & Transparencë** – krijimi i një strukture të fortë qeverisëse, me politika të qarta për menaxhimin e rreziqeve dhe llogaridhënie të plotë.
- **Kontroll & Vetërregullim** – forcimi i sistemeve për mbikëqyrjen e cilësisë së auditimit sipas standardeve ISQC dhe ISA.
- **Edukimi Profesional i Vazhdueshëm** – zgjerimi i programeve CPD dhe mentorimit për audituesit e rinj, duke përfshirë trajnime për analizë të dhënash, auditim dixhital dhe raportim të qëndrueshmërisë (ESG).
- **Transformim Dixhital** – investime në sisteme IT, analiza të avancuara të të dhënave dhe platforma e-learning 24/7 për anëtarët.
- **Etikë & Pavarësi** – zbatimi i Kodit Ndërkombëtar të Etikës (IESBA) për të garantuar integritet dhe profesionalizëm.
- **Angazhim Global** – bashkëpunim me organizata ndërkombëtare për shkëmbim përvojë dhe përafrim me praktikat më të mira.



Këto veprime do t'i mundësojnë IEKA-s të rrisë besueshmërinë, të mbajë integritetin profesional dhe të mbetet lider në zhvillimin e profesionit të auditimit në Shqipëri, por edhe në rajon.

PRIORITET E SFIDAT

SFIDAT KRYESORE

- Ruajtja e Cilësisë Profesionale – shmangia e rënies së standardeve dhe tërheqja e brezave të rinj të audituesve.
- Risku i Reputacionit – nevoja për të ruajtur statusin e inovatorit në tregun ekonomik e ligjor.
- Risku Rregullator – mundësia e ndryshimit të funksioneve ligjore për shkak të luhatjeve në cilësinë e anëtarësisë.
- Presioni Financiar – rritja e kostove për personelin, tarifat ndaj Bordit të Mbikëqyrjes Publike dhe kërkesa për investime në teknologji.

PLANI I VEPRIMIT

- Diversifikim i Burimeve – përmes programeve të reja trajnimi dhe partneriteteve me donatorë.
- Përmirësim i Infrastrukturës Teknologjike – përdorim i inteligjencës artificiale dhe mjeteve të analitikës për auditime më të sakta e më të shpejta.
- Fuqizim i Marrëdhënieve me Anëtarët – procese të qarta komunikimi, feedback të rregullt dhe shërbime me vlerë të shtuar.



KONTAKT

Telefon/

+355 4 23 46 077

Email/

info@ieka.al

Adresa

Rr.Elbasanit, Pallati EDIL-AL-IT. PO
Box 1437. Tiranë, Shqipëri

Website/

www.ieka.al

